



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 16 maj 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadrijaj, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi, Liburn Aliu, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq dhe Flora Brovina.

Mungoi: Fikrim Damka,

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit, Ukë Gashi – presidencë, Ervin Ibrahim –UNDP , Fehmir Smaili dhe Shefki Kastrati - NDI, Florije Mehmeti – KDI dhe Nita Krasniqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Time Kadrijaj -nënkryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.04.2012**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat, para miratimit në parim**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.04.2012

Kryesuesja konstatoi se procesverbali nga mbledhja e datës 25.04.2012, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat, para miratimit në parim

Time Kadrijaj – Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat i është shpërnda deputetëve me dt. 7 maj 2012 dhe i ka plotësuar kushtet për shqyrtim në seancë plenare. Ne si Komision duhet të japim një rekomandim për miratimin në parim të këtij Projektligji. Projektligji nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga ligji ekzistues, gjatë amendamentimin ne do të bëjmë përpjekje ta bëjmë një ligj sa më të mirë. Hap diskutimin:

Salihe Mustafa – Tha se në këtë Projektligj risi është ndërmjetësimi , ku ndërmjetësuesit e licencuar duhet të ndërmjetësojnë në mes të punësuarve dhe punëdhënësve, ndërsa ndryshimet tjera janë më shumë ndryshime teknike . Rekomandoj që të miratohet në parim Projektligji , ndërsa gjatë amendamentimit të kontribojmë që të jetë një ligj sa më i mirë.

Flora Brovina – Theksoj se ky Ligji i grevave ka disa mangësi që lidhen me Ligjin e punës dhe ka qenë e nevojshme që ky Ligj të harmonizohet me Ligjin e punës, sepse është një derivat i Ligjit të punës. Duhet të përkrahet miratimi në parim i këtij Projektligji.

Bahri Thaqi – Tha se ky ligj nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga ligji ekzistues , por më shumë ka qëllim harmonizimin me standardet e BE- së . Kjo është një diçka e mirë por përveç harmonizimit me BE- në ne duhet që të angazhohemi që këto ligje të miratuara të zbatohen sepse pengesa më e madhe është te zbatimi i ligjeve.

Nazane Breca – Ne veç kemi filluar monitorimin e zbatimit te ligjit të punës dhe në bazë të mangësive dhe problemeve që hasin në zbatim, ne mund ta plotësojmë edhe Ligjin e grevave dhe ta harmonizojmë me Ligjin e punës.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të :

R e k o m a n d o n

Të miratohet në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-200 për grevat

Komisioni formoj edhe grupin punues për amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat në këtë përbërje :

Sasha Dgjokiq – kryesues

Time Kadrijaj – anëtare

Nazane Breca – anëtare

Salihe Mustafa – anëtare

Flora Brovina – anëtare

Liburn Aliu – anëtar

4. Të ndryshme

Time Kadrijaj – Në piken të ndryshme kemi dy shkresa një nga Sindikata e Shëndetësisë, që kërkon interpretimin e nenit 11 të Ligjit për Organizimin Sindikal, dhe një shkresë tjetër nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut që ka të bëjë me peticionin e Rrjetit të Grupit të Grave. Hap diskutimin :

Pas diskutimeve Komisioni këtë përfundim :

Lidhur me shkresën e Sindikatës së Shëndetësisë që kërkon interpretimin e nenit 11 të Ligjit për Organizimin Sindikal , sipas rregullativës ligjore në fuqi , interpretimi i ligjeve bëhet nga gjykata , prandaj Kuvendi dhe komisionet përkatëse nuk bëjnë interpretimin e ligjeve.

Shkresa tjetër është nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut që ka të bëjë me peticionin e Rrjetit të Grupit të Grave . Hap diskutimin .

Flora Brovina - Rekomandimet që ka bërë Komisioni për të Drejtat e Njeriut nuk janë shumë me vend sepse kjo kategori e grave të dhunuara gjatë luftës nuk mund të përfshihet në skemat e ndihmës sociale , kjo është një kategori e dhimbshme dhe e veçantë. Kjo kategori mbulohet me Ligjin e kategorive të luftës, ndërsa ne duhet të bëjmë një takim dhe të dëgjojmë se në të vërtetë si mund të ju ndihmojmë kësaj kategorie të grave. Kjo kategori e grave ka mjaft probleme çoftë shëndetësore qoftë financiare dhe nuk ka pas shumë përkrahje.

Time Kadrijaj – Kategoria e grave të dhunuar gjatë Luftës, është një kategori e dhimbshme dhe duhet të kenë një trajtim adekuat nga shoqëria, duhet pas parasysh edhe mentalitetin që kemi në Kosovë . Një gjë me rëndësi për të ju ndihmuar kësaj kategorie është evidentimi i tyre nga një komision Qeveritar.

Salihe Mustafa – Propozoj që të ftohet kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut që të na sqarojë më tepër kërkesat e këtij peticioni.

Nazane Breca – Mendoj se kjo kategori duhet të ketë një ligj të veçantë , dhe të ndahet një buxhet i veçantë për këtë kategori duke pas parasysh situatën në të cilën ndodhen shumica e kësaj kategori , pa asnjë lloj përkrahje. Kjo iniciativë për të ndihmuar është mjaft e vonuar.

Bahri Thaçi – Pengesë e madhe në këtë drejtim është evidenca e saktë e tyre , këtu ka ndikuar edhe mos angazhimi institucional por edhe mentaliteti në Kosovë, që këto gra mos të ndihen të diskriminuara dhe të dëmtuara.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të ketë takim me Komisionin Qeveritar për evidentimin e kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit

Time Kadrijaj